

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Zhvillim
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm, nuk ka përafrim me legjislacionin e BE-së
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Nuk ka përafrim me legjislacionin e BE-së
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Strategjia Ndërsektorale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.709, datë 29.10.2014 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektorale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020” Strategjia e Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjes së Tregut 2020, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 753, datë 16.9.2015, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare Ndërsektorale për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2015 - 2020”
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	8-10-2019 & 3-06-2019
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	24.6.2019
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	15.7.2019
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2019 – MBZHR- Nr.3
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Luljeta Çuko <i>e-mail-i:</i> luljeta.cuko@bujqesia.gov.al numri i telefonit: 0684681827 Entela Kola <i>e-mail-i:</i> entela.kola@bujqesia.gov.al numri i telefonit: 0688535551 Glaudjana Musaj <i>e-maili:</i> glaudiana.musaj@bujqesia.gov.al numri i telefonit: 0688846379
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)	

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja e qeverisë?

Njohja dhe evidentimi i çdo hallke të zinxhirit ushqimor është i një rëndësie të veçantë për garantimin e shëndetit publik dhe mbrojtjen e interesit të konsumatorit në përgjithësi. Çdo hallkë e zinxhirit ushqimor është i përbërë nga një kompleks standardesh zbatimi dhe kontrolli i të cilave i garanton sigurinë ushqimore. Gjatë këtyre viteve është konstatuar se një numër i konsiderueshëm biznesesh kontrolloheshin për aspekte të ndryshme të sigurisë ushqimore nga dy inspektoriate. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) dhe Inspektoriat Shtetëror Shëndetsor (ISHSH). Kjo vinte si rezultat i disa dispozitave të paqarta në ligjin për ushqimin dhe atij që rregullon veprimtarinë e ISHSH. Plotësimi i strukturës së vendeve vakante të AKU-së, kërkon një kohë të gjatë për rekrutimin e punonjësve sipas Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”. Duke qenë se AKU është një institucion dinamik dhe detyrë kryesore ka garantimin e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve mbajtja për një kohë të gjatë i vendeve vakante do të dëmtonte kryerjen e detyrave funksionale të saj me pasoja të drejtpërdrejta në jetën dhe shëndetin e njerëzve. Nga ana tjetër gjatë zbatimit të ligjit të ushqimit është konstatuar se ligji aktual, nuk parashikon nxjerrjen e një numri të konsiderueshëm të akteve nënligjore, për të cilat është detyrim përafrimi dhe janë të lidhura direkt me hapjen e eksporteve shqiptare. Gjithashtu, gjatë praktikës së zbatimit të ligjit janë konstatuar se ligji ka nevojë për disa rregullime ligjore që lidhen me mungesën e hapësirës për të nxjerrë akte nënligjore të cilat nuk janë përafrim, si dhe shfuqizimin e disa parashikimeve, për nxjerrje aktesh nënligjore, të cilat aktualisht nuk janë të nevojshme të jenë.

Ndërhyrja e parashikuar nëpërmjet politikave që propozohen, mundëson që Ligji nr. 9863, datë 28.1.2008, i ndryshuar, të forcojë kapacitetet kontrolluese të AKU-së, nëpërmjet zgjerimit të bazës së kontrollit për operatorët e bizneseve ushqimore duke përfshirë edhe biznese që aktualisht inspektohen nga ISHSH. Kalimi i kompetencës së inspektimit nga ISHSH tek AKU forcon më tej sigurinë ushqimore dhe ul barrën e inspektimit nga 2 organe inspektimi për të njëjtat kategori biznesesh. Gjithashtu, projektligji parashikon (përcakto bazën ligjore) për nxjerrjen e disa akteve nënligjore, për të rritur shkallën e përafërt me legjislacionin e BE-së, të legjislacionit sekondar, apo shfuqizimin e disa parashikimeve, për nxjerrje aktesh nënligjore.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

- Plotësimi i AKU me stafin që ka në organikë, brenda vitit 2020.
- AKU të realizojë 100% planin e kontroleve zyrtare me bazë risku dhe marrjes së mostrave për çdo vit.
- Ulja e barrës së inspektimit për bizneset duke kaluar kompetencat e inspektimit nga ISHSH tek AKU.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Për arritjen e objektivave të politikës janë shqyrtuar opsionet e mëposhtme:

- Opsioni 0 (*status quo*): Nuk do të ndërhyjmë me ndryshim apo politikë të re;
- Opsioni 1: Ndryshimi i ligjit ekzistues “Ligji nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, i ndryshuar;
- Opsioni 2: Hartimi i një ligji të ri “Për ushqimin”.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Ndikimet ekonomike të opsionit të preferuar do të përfshijnë kostot e drejtpërdrejta për sektorin publik (AKU, procesi i monitorimit).

Kostot e drejtpërdrejta për sektorin publik, rrjedhin nga zbatimi i pikës 7, të nenit 50 të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, për ndryshimin e rregullimit të marrëdhënieve të punës së nëpunësve të AKU. Efekti total afërsisht është 110,400 mijë lekë, referuar një page mesatare 62.000 lekë: 281 punonjës paguhen me 6 paga mujore dhe 32 punonjës paguhen me 3 paga mujore, sipas nivelit të vjetërsisë në Administratën Publike.

Do të ketë gjithashtu edhe *disa lloje ndikimesh jo të drejtpërdrejta ekonomike*, që janë pa vlerë monetare të drejtpërdrejta në buxhet dhe konsistojnë në rritjen e përgjegjësisë së subjekteve që zhvillojnë aktivitetin e prodhimit dhe tregimit të produkteve ushqimore si rezultat i forcimit të kontrollit gjatë të gjithë zinxhirit ushqimor, pra një ushqim i sigurt garanton një jetë të shëndetshme, e si pasojë shpenzimet për kujdesin shëndetësor, reduktohen.

Ndikimi mjedisor i drejtpërdrejtë

Forcimi i kontrollit gjatë gjithë zinxhirit ushqimor ka për qëllim sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe interesave të konsumatorit si dhe mbrojtjen e mjedisit nga prodhimi, përpunimi, ruajtja, transporti dhe tregtimi i produkteve ushqimore.

Ky ligj zbatohet për operatorët e biznesit ushqimor që ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në këtë ligj dhe licencimi i këtyre veprimtarive kërkon pajisjen me lejen e mjedisit për secilin subjekt që ushtron aktivitetin, para licencimit. Është kusht që për subjektet të cilët do të zhvillojnë aktivitetin e prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes së ushqimeve, përpara miratimit të licencimit duhet të paraqesin lejen e mjedisit. Për sa më sipër nuk ka ndikim në mjedis.

Ndikimi Social i drejtpërdrejtë

Ndryshimi i statusit të punonjësve dhe inspektorëve të AKU-së, lehtëson procedurat e rekrutimit të tyre dhe do punësohen me procedura më të thjeshta, 79 punonjës në vendet e lira. Ndikim jo të drejtpërdrejtë do të ketë edhe tek konsumatori për produkte ushqimore më të sigurta dhe cilësore dhe shkallë më të lartë gjurmueshmërie.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Analiza me shumë kriterë e kryer për të tre opsionet tregoi se opsioni 1, ndryshimi i ligjit ekzistues “Ligji nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, i ndryshuar, është vlerësuar me më shumë pikë dhe ne e kemi zgjedhur atë si opsionin tonë të preferuar. Me opsionin e përzgjedhur do të bëhet e mundur lehtësimi i barrës së biznesit nga inspektimi i dyfishtë i të

njëjtëve operatorë nga dy insepktoriato të ndryshme si dhe nëpërmjet shkurtimeve të procedurave të rekrutimit të punonjësve, AKU do të plotësohet me stafin e miratuar dhe për rrjedhojë do të realizojë kryerjen e një kontrolli zyrtar efikas.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare, menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3
110,400,000	0	0

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?) çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsye pse?)

Më datë 3.6.2019 projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar së bashku me relacion shpjegues janë publikuar për konsultim publik në Regjistrin Elektronik të Konsultimit Publik në ëebsite <http://www.konsultimipublik.gov.al>. Nuk ka ardhur asnjë koment lidhur me projektligjin. Më datë 8.10.2019 projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9863, datë 28.1.2008”, “Për ushqimin”, i ndryshuar së bashku me relacionin shpjegues janë publikuar sërish për konsultim publik në Regjistrin Elektronik të Konsultimit Publik në website <http://www.konsultimipublik.gov.al>. Data e mbylljes së konsultimit është 6.11.2019. Më datë 30.10.2019 është organizuar një takim me grupet e interesit ku është diskutuar analiza e ndikimit të këtij projektakti pas disa ndryshimeve të bëra në të.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Zbatimi dhe monitorimi do të realizohen sipas përcaktimeve të dispozitave të projektligjit. Autoritetet përgjegjëse për çështjet e sigurisë ushqimore janë të njëjta me ato të përcaktuara në ligjin e ushqimit në fuqi:

- Strukturat përgjegjëse për sigurinë ushqimore në MBZHR;
- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit;
- Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Strukturat përgjegjëse për sigurinë ushqimore në MBZHR janë përgjegjëse për hartimin e politikave, legjislacionit dhe strategjive në këtë fushë si dhe janë të përfshira në menaxhimin e riskut ushqimor.

Kontrolli për zbatimin e këtij ligji dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tij ushtrohet nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, sipas detyrave, të drejtave dhe përgjegjësisë të përcaktuara në legjislacionin në fushën e ushqimit.

Rekrutimi i stafit realizohet nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe monitorohet nga Drejtoria përkatëse në Ministri.

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë është Qendër Kombëtare Reference në fushën e sigurisë ushqimore.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Gjatë zbatimit ndër vite të Ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar janë vënë re mangësi të cilat ndikonin në mënyrë të drejtpërdrejtë të sigurisë ushqimore. Që nga viti 2008, kur ky ligj është miratuar, ka pësuar dy ndryshime që lidhen me reformat e licencimit dhe inspektimit të ndërmara në vendin tonë.

Ndërkohë situata e sigurisë ushqimore në tregun ndërkombëtar, pjesë e të cilit ne jemi, ka kërkuar ndryshime të shpeshta të legjislacionit në fushën e sigurisë ushqimore. Me qëllim që të rritet garancia për sigurinë e produkteve ushqimore që konsumojmë por edhe të mos pengohet importi dhe eksporti i tyre, ka dalë domosdoshmëri hartimi i kateve nënligjore dhe përafrimi i tyre me legjislacionin e Kapitullit 12 të Acquis së BE-së. Ligji aktual nuk ka parashikuar nxjerrjen e akteve nënligjore për të gjithë titujt e këtij kapitulli, duke vënë në vështirësi kontrollin në të tilla raste por nga ana tjetër bën të pamundur plotësimin e detyrimit për përafrimin e legjislacionit.

Rregullimet e bëra me anë të këtij projektligji synojnë të pasqyrojnë, si në lidhje me rekrutimin e punonjësve ashtu edhe me funksionet e AKU-së, konsolidimin e tij si autoriteti inspektues më i lartë në fushën e sigurisë ushqimore si dhe të gjithë hapësirës së fushëveprimit të Ministrisë.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) është përfshirë në institucionet e parashikuara në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” dhe për rrjedhojë procedurat e punësimit realizohen sipas parashikimeve të kuadrit ligjor për nëpunësit civil. Problemi lidhet me mos kryerjen e plotë të funksioneve dhe detyrave të ngarkuara me ligj nga AKU, plotësimin në kohë të vendeve të lira si rezultat i kompleksitetit procedural dhe shtrirjes në kohë të procesit të rekrutimit në shërbimin civil nga DAP.

Pavarësisht përpjekjeve që AKU bën për menaxhimin sa më të mirë të stafit ekzistues, për plotësimin e detyrave, por edhe për adresimin e situatave që krijohen në lidhje me sigurinë e

ushqimeve, që qarkullojnë në tregun shqiptar, përsëri siguria ushqimore në Shqipëri haset me mosmbulim të plotë me kontroll zyrtar. Shkakët kryesore të këtij problemi janë:

- Mos plotësimi me stafin e nevojshëm;
- Buxhet i pamjaftueshëm për kontrollin e sigurisë ushqimore.

Problemi me mosplotësimin e AKU-së, me stafin e nevojshëm prek të gjitha nivelet e organizimit të AKU-së, në nivel qendror (drejtoria e përgjithshme) dhe në nivel rajonal (12 drejtoritë rajonale). Ky problem kthehet në mos dhënie të garancisë së plotë të konsumatorit për sigurinë e produkteve që qarkullojnë në tregun shqiptar. Nga ana tjetër në vendosjen e biznesit ushqimor në një situatë jo të barabartë në lidhje me frekuencën e kontrollit të cilat momentalisht është e lidhur me numrin e inspektorëve që AKU ka në çdo qark dhe jo në bazën e riskut që këta operatorë biznesi paraqesin.

Grupet e interesit të prekura nga ky problem janë: Qeveria (Ministria, AKU)/ biznesi (operatorët e biznesit ushqimor që importojnë, prodhojnë, ruajnë dhe tregtojnë produkte ushqimore)/ qytetarët (konsumatorë vendas dhe të huaj).

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Ndërhyrja me këtë ligj është e nevojshme, për arsye të rregullimit të kësaj faze të vështirë të kryerjes së detyrave nga AKU. Në të njëjtën kohë ndërhyrja në ligj është i domosdoshëm edhe në kuadër të rishikimit të dispozitave ekzistuese të kodit Penal që lidhen me sigurinë ushqimore dhe krijimin e figurave të reja të veprave penale, duke kriminalizuar fenomene/sjellje, të cilat, aktualisht, janë kategorizuar si forma të kundërvajtjeve administrative apo nuk kanë asnjë parashikim të mirëfilltë ligjor si shkelje. Në këtë kuadër janë identifikuar disa mungesa ligjore të cilat do bëhen pengesë për zbatimin e ndryshimeve në Kodin Penal.

Nga sa më sipër, vlerësohet se është i nevojshëm ndryshimi i ligjit ekzistues për ushqimin, me qëllim:

- a) Zbatimin e rekomandimeve të progres raporteve të viteve të fundit të BE-së, për Shqipërinë, për të forcuar kontrollin zyrtar të ushqimeve;
- b) Përmbytjen e detyrave nga AKU;
- c) Rritja e garancisë tek konsumatori për sigurinë e ushqimeve që qarkullojnë në tregun shqiptar .

Kjo ndërhyrje lidhet me objektivin e qeverisë së Shqipërisë, drejt përmbytjes së kriterëve për hapjen e negociatave për anëtarësim në BE, duke synuar përafrimin e plotë të legjislacionit kombëtar me atë të Bashkimit Evropian të paraqitur në nivel kombëtar në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian.

Pas takimit shpjegues të Kapitullit 12 në muajin shkurt, në Bruksel, Ministria ka identifikuar legjislacionin aktual shqiptar që ka nevojë të përditësohet me atë evropian, ku do mbështetet

nga Projekti IPA 2016, për standardet e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve.

Plotësimi i strukturës së vendeve vakante të AKU-së, kërkon një kohë të gjatë për rekrutimin e punonjësve sipas Ligjit për nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”. Duke qenë se AKU është një institucion dinamik dhe detyrë kryesore për garantimin e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve, mbajtja për një kohë të gjatë të vendeve vakante do të dëmtonte kryerjen e detyrave funksionale të saj me pasoja të drejtpërdrejta në jetën dhe shëndetin e njerëzve.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Politika e propozuar synon realizimin e objektivave si më poshtë:

- o Plotësimi i AKU me stafin që ka në organikë, brenda vitit 2020.
- o AKU të realizojë 100% planin e kontroleve zyrtare me bazë risku dhe marrjes së mostrave për çdo vit.
- o Ulja e barrës së inspektimit për bizneset duke kaluar kompetencat e inspektimit nga ISHS tek AKU.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Gjatë analizës së kryer, janë shqyrtuar të tre opsionet:

- Opsioni i status quo-së (0): Moszbatimi i plotë i dispozitave të ligjit ekzistues, për shkak të ndryshimeve dhe reformave të zbatuara vitet e fundit në administratën publike, nuk lejojnë kryerjen e plotë të detyrave dhe përgjegjësi në kontrollin e ushqimeve, monitorimin e situatës dhe menaxhimin e riskut.
- Opsioni 1: Ndryshimi i ligjit ekzistues. Përkatësisht është rekomanduar opsioni për hartimin e kësaj politike, pra rishikimi i ligjit ekzistues për ushqimin, e cila lind edhe si nevojë për të përcaktuar qartë konsolidimin e institucionit të vetëm përgjegjës, për garantimin e sigurisë ushqimore, si dhe për të arritur përafrimin në masën 100% të legjislacionit të BE-së, për sigurinë ushqimore.

Ky opsion parashikon zgjidhjen e problemit të lidhur me bazën ligjore për hartimin e legjislacionit sekondar dhe përafrimit të tij me legjislacionin e BE-së. Ndërkohë, me ligjin aktual janë krijuar vështirësi në hartimin e këtij legjislacioni, pasi në të nuk është shprehur qartësisht akti që duhet nxjerrë për zbatim dhe forma e miratimit të tij. Projektligji do të përmbajë edhe dispozita deleguese të cilat do të shërbejnë si bazë për nxjerrjen e akteve nënligjore që do të transpozojnë (pjesërisht/plotësisht) legjislacionin e BE-së, për këtë fushë. Përveç të tjerash mungesa e këtij legjislacioni pengon edhe eksportet dhe importet e produkteve ushqimore jo vetëm me Bashkimin Evropian, por

edhe me vendet e rajonit, të cilat kanë përafruar në legjislacionin e tyre legjislacionin e BE-së.

Ky opsion ndryshon edhe procedurën e rekrutimit të stafit të AKU-së, duke i dhënë më tepër frymëmarrje këtij procesi dhe duke zhblllokuar situatën e krijuar, e cila ndikon drejtpërsëdrejti tek konsumatori, operatorët e biznesit si dhe marrëdhëniet tregtare të vendit tonë.

- Opsioni 2: Ligj i ri për ushqimin. Përafrimi i plotë i legjislacionit evropian për sigurinë ushqimore do të sillte kosto më të lartë dhe zgjatjen e procedurave, për hartimin dhe miratimin e tij, si dhe do të prekte edhe çështje që nuk është e nevojshme të ndërhyet në këtë moment.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
Për ndikimet e drejtpërdrejta:
 - o *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - o *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - o *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - o *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:
 - o *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - o *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
Diskutoni kufizimin e analizës.
 - o *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - o *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
 - o *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:
 - o *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 - o *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
 - o *Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*
 - *Identifikoni se kush preket.*

Për efekt të këtij vlerësimi të ndikimit dhe në mungesë të politikës, ne supozojmë se siguria e produkteve ushqimore në Republikën e Shqipërisë nuk do të menaxhohet si duhet, nuk do të ketë një sistem cilësor të kontrollit, si dhe nuk do të merren masat e duhura për garantimin e saj, në rast se nuk kryejmë ndërhyrjet e duhura ligjore.

Opsioni 1, i propozuar për ndryshimin e ligjit ekzistues prek grupet e mëposhtme:

- AKU;

- Operatorët e biznesit ushqimor (prodhues dhe importues) (OBU);
- Konsumatorët.
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
Për ndikimet e drejtpërdrejta:
 - o *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - o *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - o *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - o *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*

Ndikimet ekonomike

- Ky propozim do të sjellë rritje të fondeve shtesë nga buxheti i shtetit
- Kostot e drejtpërdrejta për sektorin publik, rrjedhin nga zbatimi i pikës 7, të nenit 50 të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, për ndryshimin e rregullimit të marrëdhënieve të punës së nëpunësve të AKU.

Ndikimet mjedisore

Objektivi është zhvillimi i një prodhimi ushqimor të qëndrueshëm dhe me cilësi nëpërmjet zhvillimit të një sektori agroushqimor konkurrues dhe novator, të aftë për të përballuar presionin e konkurrencës në tregjet e brendshme dhe të BE-së, si dhe që të përmbushë standardet dhe kërkesat e tregut të BE-së. Vendosja e kushtit që subjektet të cilët do të zhvillojnë këtë aktivitet përpara licencimit duhet të paraqesin lejen e mjedisit, jep ndikimet e veta pozitive në mjedis.

Ndikimet sociale:

Ndryshimi i procedurës së rekrutimit të stafit të AKU-së, bën të mundur punësimin e rreth 80 personave në një kohë relativisht të shkurtër.

Plotësimi i AKU-së, me stafin e nevojshëm bën të mundur që të rritet veprimtaria kontrolluese e saj gjë që sjell shtimin e besueshmërisë së konsumatorit ndaj institucioneve të kontrollit të ushqimeve. Por nga ana tjetër shtimi i kësaj veprimtarie jep garanci më të lartë për shëndetin dhe interesat e konsumatorëve.

- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - o *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - o *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*

Ndikimet ekonomike

Ndikime jo të drejtpërdrejta ekonomike, që janë pa vlerë monetare të drejtpërdrejtë në buxhet dhe konsistojnë në rritjen e përgjegjësisë së subjekteve që zhvillojnë aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore si rezultat i forcimit të kontrollit gjatë të gjithë zinxhirit ushqimor, pra një ushqim i sigurt garanton një jetë të shëndetshme, e si pasojë shpenzimet për kujdesin shëndetësor, reduktohen.

Rritja dhe forcimi i kontrollit, luan rol në formalizimin e bizneseve jo të tillë, duke ndikuar indirekt në të ardhurat për buxhetin e shtetit.

Diskutoni kufizimin e analizës:

- o *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u*

nënshtrohen.

- o *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
- o *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*

Rritja dhe fuqizimi i industrisë ushqimore në vend por edhe zgjerimi i marrëdhënieve tregtare të vendit tonë dhe rritja e futjes së produkteve ushqimore në tregjet ndërkombëtare mund të kërkojnë të ketë një numër më të madh të punonjësve që kryejnë kontrollin zyrtar të tyre. Kontrolli zyrtar kryhet gjithmonë nga institucione shtetërore buxhetore pasi është një kompetencë e cila nuk delegohet dhe si e tillë ka varësi nga buxheti i shtetit. Risku që vjen nga kjo varësi është i ulët, pasi do ketë përparësinë që duhet lidhur me shëndetin e konsumatorit.

Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:

- o *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
- o *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
- o *Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Opsionet e vlerësuara nga grupi teknik i punës u kryen duke analizuar numrin e dispozitave dhe neneve që ndryshohen dhe shtohen për të arritur qëllimet/objektivat e këtij projektakti. Krahasimi është bërë duke u nisur nga numri total i neneve të projektligjit ekzistues dhe nenet që ndryshohen dhe shtohen. Në përfundim u arrit në konkluzionin që paraqitja e projektaktit të jetë në formën e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni i preferuar është hartimi dhe miratimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar, bazuar në analizën me shumë kriterë.

Opsionet që merren në konsideratë janë:

- Opsioni 0 (*status quo*): Nuk do të ndërhyjmë me ndryshim apo politikë të re;
- Opsioni 1: Ndryshimi i ligjit ekzistues “Ligji nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, i ndryshuar;
- Opsioni 2: Hartimi i një ligji të ri “Për ushqimin”.

Për të vlerësuar opsionet duke përdorur analizën me shumë kriterë, janë ndjekur hapat e mëposhtëm:

1. Përcaktimi i kriterëve që tregojnë arritjen e objektivit për të garantuar shëndetin e njerëzve nga rritja e sigursë ushqimore:

- Efektiviteti në realizimin 100% të planit vjetor të kontrollit;
- Efektiviteti i lehtësimit të barrës së biznesit nga inspektimet e dyfishta;
- Efektiviteti i hartimit dhe zbatimit të standardeve të sigursë ushqimore;

- Aftësia gjyquese në masat administrative të marra;
- Shkalla e riskut të sigurisë ushqimore;
- Kostot.

2. Vendosja e peshës së kriterëve sipas rëndësisë relative

- Efektiviteti në realizimin 100% të planit vjetor të kontrollit: 5;
- Efektiviteti i lehtësimit të barrës së biznesit nga inspektimet e dyfishta: 3;
- Efektiviteti i hartimit dhe zbatimit të standardeve të sigurisë ushqimore: 4;
- Aftësia gjyquese në masat administrative të marra: 2;
- Shkalla e riskut të sigurisë ushqimore: 6;
- Kostot: 5.

3. Përcaktimi i **shkallës së performancës** nëpërmjet intervalit të pikëve nga 0 – 6.

4. **Vendosja e pikëve të opsioneve** përkundrejt secilit kriter sipas matricës së mëposhtme.

Matrica e performancës:

Kriteret	Pesha (Rëndësia relative)	Opsioni 0		Opsioni 1		Opsioni 2	
		Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)	Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)	Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)
Efektiviteti në realizimin 100% të planit vjetor të kontrollit	5	0	0	5	25	5	25
Efektiviteti i lehtësimit të barrës së biznesit nga inspektimet e dyfishta	3	0	0	3	9	3	9
Efektiviteti i hartimit dhe zbatimit të standardeve të sigurisë ushqimore	4	3	12	5	20	1	4
Aftësia gjyquese në masat administrative të marra	2	2	4	4	8	4	8
Shkalla e riskut të sigurisë ushqimore	6	6	36	1	6	1	6
Kostot	5	1	5	4	20	4	20
Pikët totale për secilin opsion			57		88		72

Analiza me shumë kriterë tregon se opsioni 1 (ndryshimi i ligjit ekzistues “Ligji nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, i ndryshuar) është vlerësuar me më shumë pikë dhe ne e kemi zgjedhur atë si opsionin tonë të preferuar.

Ky opsion përmbush zgjidhjen e të gjitha vështirësive të krijuara, për garantimin e sigurisë ushqimore, nëpërmjet kryerjes së kontrollit zyrtar në mënyrë efektive dhe efikase.

Çështje të zbatimit

- Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.

- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, së bashku me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, janë institucionet përgjegjëse për monitorimin e zbatueshmërisë së tij, pas miratimit të këtij propozimi.

Pengesa e mundshme që mund të haset është forcimi i kapaciteteve kryesisht në kryerjen e kontrollit zyrtar, nëpërmjet trajnimeve me kostot përkatëse.

Gjatë zbatimit të projektligjit të propozuar, për të arritur qëllimet e politikës, do të ndërmerren masat e mëposhtme:

- Plotësimi me akte nënligjore i ligjit, që lidhet me standardet që duhet të plotësojnë stabilimentet ushqimore, produktet ushqimore dhe materialet në kontakt me to.
- Forcimi i kontrollit të produkteve ushqimore që prodhohen në vend.
- Forcimi i kontrollit të produkteve ushqimore të importuar dhe kushteve të importimit.
- Rritja e kapaciteteve të stafit inspektues, nëpërmjet përcaktimit të një programi të qartë trajnimi.
- Mbështetja e zbatimit të Kodit Penal, në ashpërsimin e masave për shkelësit e standardeve të sigurisë ushqimore.
- Fushata ndërgjegjësimi të konsumatorëve në lidhje me rolin e madh të tyre në sigurinë ushqimore.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Propozimi i këtij projektligji përmban elementë të rëndësishëm, për zbatimin e planit të punës, për sistemin e monitorimit dhe vlerësimit në zbatimin e ligjit, bazuar në problemet e konstatuara.

Indikatorët për të matur arritjen e objektivit janë si më poshtë:

- Shkalla e perceptimit të konsumatorit në lidhje me sigurinë e produkteve ushqimore që konsumojnë;

- Realizimi i Planit kombëtar të kontrolleve zyrtare me bazë risku dhe marrjes së mostrave;
- Hartimi i legjislacionit në fushën e sigurisë ushqimore në përputhje me Kapitullin 12 të Acquis;
- Monitorimi i sistemit të sigurisë ushqimore nga “ferma” në “tavolinë”.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e koston dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – një herë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – një herë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – një herë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total										
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										

Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e kostos në total										
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

Raporti i ndikimit të vlerësimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			

Grupi i punës dhe RIA: